VENDIM
Nr.15, datë 28.2.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "HP OSTROVICA ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa "a", nenit 9 dhe 13, pika 1 germa "d", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa "g", nenit 8, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa "a" të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.2.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Hp Ostrovica Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hp Ostrovica Energy" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë "Hp Ostrovica Energy" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta